

VENDIM
Nr.954, datë 24.11.2010

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË SHPALLJES E TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE INSTITUCIONET E SAJ TË VARËSISË, SI AUTORITETE KONTRAKTORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të institucioneve të saj të varësisë, si autoritete kontraktore, që brenda datës 20 dhjetor 2010, të përfundojnë procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe punë civile, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2010, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, institucionet e saj të varësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

LISTA E OBJEKTEVE TË MBMUK-SË DHE INSTITUCIONEVE TË SAJ TË VARËSISË, PËR TË CILAT KËRKOHET LEJIMI I PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Nr.	Autoriteti kontraktor	Fondi limit në lekë (me TVSH)	Objekti i prokurimit	Faza e procedurës
1	Bordi i kullimit Shkodër	50 000 000	Rehabilitim i argjinaturës së Çasit	Njoftim fituesi
2	Bordi i kullimit Elbasan	3 766 560	Diga e rezervuarit Posnovisht, Elbasan	Njoftim fituesi
3	Bordi i kullimit Mat	8 974 000	Rehabilitimi i rezervuarëve Bejn 1, Bejn 2, Klos, Mat	Njoftim fituesi
4	Bordi i kullimit Durrës	3 979 992	Diga e rezervuarëve zona Fushë-Krujë, Durrës	Njoftim fituesi
5	Bordi i kullimit Tiranë	2 000 000	Diga e rezervuarit Beden, Kavajë	Njoftim fituesi
6	Bordi i kullimit Korçë	1 282 000	Blerje karburanti	Njoftim fituesi
7	DRBU&MK Tiranë	762 000	Roje të sigurisë së objekteve të sektorit Tiranë dhe Kavajë	Njoftim fituesi
	Totali	70 764 552		